



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 587/1 Prot.

Tiranë, më 14.04.2025

V E N D I M

Nr. 90, datë 14.04.2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, shqyrtoi ankesën 82, datë 03.04.2025 të z. Sh. B., kundër Bashkisë Patos, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Unë, i nënshkruari Sh. B., banor i qytetit Patos, me profesion Jurist, i drejtohem Institucionit tuaj pasi ndihem i diskriminuar për arsyet që do t'i parashtroj në vijim. Kam punuar pranë Bashkisë Patos që nga viti 2011 deri më 18.12.2024. Pozicionin si Sekretar i Përgjithshëm e kam mbajtur nga 1 janar 2020 deri më 18.12.2024. Më datë 08.03.2024, me vendim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është marrë ndaj meje masa e sigurisë ndaluese "Pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", si rrjedhojë dhe u pezullova nga funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm, ku sipas legjislacionit të shërbimit civil, nuk e humbisja vendin e punës.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Më datë 03.05.2024, me vendim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, jam marrë i pandehur dhe më është komunikuar akuza. Nga dita e parë e punës, datë 26.09.2024, jam ndeshur çdo ditë me një ambient diskriminues ndaj meje, të cilat i kam parashtruar edhe në ankesën që kam bërë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me nr. 241, datë 19.11.2024. Edhe pas kësaj date, diskriminimi ndaj meje ka vazhduar, konkretisht më datë 27.11.2024, me Vendimin nr. 83 të Këshillit të Bashkisë Patos, ku është miratuar niveli i pagave për nënpunësit civil të Bashkisë. Propozimi është bërë nga ekzekutivi i bashkisë me Projekt-Vendimin nr. 82, datë 15.11.2024. Pagat e reja të miratuara janë shumë afër maksimumit të nivelit të pagave për të gjithë nënpunësit civil, ndërsa paga ime nuk është në proporcion të drejtë me pagën e të gjithë punonjësve të tjerë, konkretisht si më poshtë:

Duket qartë që në përcaktimin e pagës time si Sekretar i Përgjithshëm ka një diskriminim të theksuar, pasi kam një trajtim të paktën 25% deri në 29% më të ulët, në krahasim me nënpunësit e tjerë civil. Duket qartë që ndaj meje nuk është bërë një trajtim i barabartë si me nënpunësit e tjerë, dhe ajo që bie më në sy është se unë, si Sekretar i Përgjithshëm, i cili jam Nënpunës i Lartë Drejtues, kam pagën më të ulët se vartësit e mi, që janë drejtorët e drejtorive, të cilët janë nivel i mesëm drejtues. Paga ime është shumë afër pagës së Përgjegjësve të Sektorëve, që janë nivel i ulët drejtues.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit. Marrjen e masave për rregullimin e aktit administrativ.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesit, mosha dhe raca, janë shkaqe të mbrojtur nga neni 1, i LMD, ku parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen shëndetësore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, *duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.*

Sipas nenit 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Me email-in e datës 07.04.2025, nga ana e ankuesit është përcjellë një Deklaratë për heqje dorë nga ankesa nr. 82, datë 03.04.2025, në të cilën ai ka shprehur se: *“Unë, Sh. B., me datë 03.04.2025 kam paraqitur një ankim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të regjistruar me numër 82. Ky ankim nuk ka lidhje me ankimin që kam bërë më datë 19.11.2024, të regjistruar me nr. 241, pasi ankimi i datës 03.04.2025 ka të bëjë me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos nr. 83, datë 27.11.2023, ndërsa ankimi i datës 19.11.2024 ka të bëjë me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Patos nr. 70, datë 30.09.2024. Kështu, ankimet janë drejtuar dy akteve të ndryshme administrative, por të nxjerra nga i njëjti organ administrativ. Duke marrë parasysh faktin që unë jam larguar nga puna më datë 18.12.2024, dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 83, datë 27.11.2023, për të cilin është bërë ankesa nr. 82, datë 03.04.2025, ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2025 dhe ndaj meje nuk ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta, unë heq dorë nga ankesa nr. 82, datë 03.04.2025.”*

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Në këto kushte, kur pala që ka iniciuar ankesën ka hequr dorë nga ankesa e saj, nuk ka asnjë arsye që justifikon vazhdimin e procedurës administrative. Pasi ankuesi ka tërhequr ankesën në mënyrë zyrtare dhe ka shprehur vullnetin për të mos e vazhduar, nuk ka më asnjë element ligjor ose procedural që justifikon mbajtjen hapur të çështjes. Prandaj, procedura duhet të mbyllet dhe të deklarohet e përfunduar, duke pasur parasysh se nuk ka më një ankesë aktive nga pala ankuese.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa 82, datë 03.04.2025 kundër Bashkisë Patos, për shkak të “gjendjes shoqërore”, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.82, datë 03.04.2025, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

